



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës
Qeveria komunale nis vitin me shpalljen e dhjetë tenderëve

16 janar 2013, Prizren

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e Komunës së Prizrenit" këtë javë ka marrë pjesë në mbledhjen e kryetarit të komunës së Prizrenit, Ramadan Muja me drejtorët komunal, ku janë miratuar disa konkluzione.

Qeveria komunale e Prizrenit në mbledhjen e parë të saj të vitit 2013 ka miratuar vendime të shumta, që kryesisht kanë të bëjnë me lejimin e shpalljes së tenderëve për kryerjen e punimeve të ndryshme në objektet arsimore, furnizim me pajisje e shërbime tjera, sikurse edhe kërkesat e caktuara të dikastereve përkatëse.

Më së shumti leje për shpallje të tenderëve ka marrë Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, të cilës i është dhënë drita e gjelbër për procedimin e shtatë tenderëve, derisa një propozim i është refuzuar. Në bazë të kërkesës së DKASH-së, ekzekutivi lokal ka miratuar shpalljen e tenderëve për: meremetimin dhe rregullimin e oborrit të SHFMU "Luigj Gurakuqi" në Nashec (parallogaria 20 mijë euro); renovimin e kulmit të SHFMU "Shtjefën Gjeçovi" në Zym (parallogaria 10 mijë euro); renovimin e kulmit të SHFMU "Heronjtë e Lumës" në Shkozë (parallogaria 10 mijë euro); riinstalimin e nxehjes qendrore në SHFMU "Fadil Hisari" në Prizren, i cili projekt sipas sqarimit të DKASH-së nuk është realizuar edhe pse ka qenë i planifikuar disa vite me radhë (parallogaria 50 mijë euro); ndërrimin e kulmit dhe punimin e nyjeve sanitare në SHFMU "Motrat Qiriazi" në Prizren (parallogaria 50 mijë euro); punimin e rrethojës së oborrit në SHFMU "Dëshmorët e Hasit" në Kabash të Hasit (parallogaria 40 mijë euro); ndërrimin e dyerve dhe dritareve në SHFMU "Sezai Surroi" në Korishë (parallogaria 45 mijë euro). Kërkesa e DKASH-së për hartimin e projekteve të ndryshme shkollore nuk është miratuar.

Qeveria lokale ka aprovuar propozimin e Drejtorisë për Shërbime Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit për identifikimin e shenjave të trafikut në komunën e Prizrenit.

Ekzekutivi i Prizrenit është pajtuar me propozimin e Drejtorisë për Administratë dhe ka lejuar shpalljen e tenderit për ndërtimin e shtatores së Ismail Kryeziut në kompleksin memorial në Arbanë, sikurse atë për furnizim me pajisje kompjuterike për nevojat e administratës komunale.

Në këtë mbledhje është miratuar edhe kërkesa e Shoqatës së të Burgosurve Politik – dega në Prizren, për mbështetje financiare në bazë vjetore. Ka kaluar edhe kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për mbështetje materiale të organizimit të ceremonisë për shpalljen e më të dalluarve në lëmitë e sportit e kulturës.

Qeveria komunale ka miratuar edhe propozimin e ardhur nga Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale rreth lejimit të shpërndarjes së druve për djegie, të cilët kanë mbetur pa u tërhequr nga disa invalidë të luftës së UÇK-së dhe të njëjtat t'i dedikohen disa familjeve skamnore.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të

gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.